<p>AKTIVITETET</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sektori i Trajnimeve përgatit kalendarin e trajnimeve për sistemin ASSYCUDA World. 2. Miratimi i kalendarit trajnues. 3. Zbatimi i programeve trajnuese. 		

PËRPARËSIA: E mesme.		
REZULTATI I PRITUR: Personeli i DK-së merr trajnim të standardizuara bazuar në nevojat e trajnimeve.		
TREGUESIT: Programet e trajnimit të DK-së janë përgatitur dhe vënë në zbatim.		
AGJENCIA PËRGJEGJËSE: DK.		
AKTORËT E PËRFSHIRË: DK, DBNJ, Sektori i trajnimeve, SAPD, TI.		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Agjencia DK		
Kostot: Të parapara në buxhetin e agjencisë.		
Përfitimet: Trajnimi dhe specializimi i personelit i bazuar në programe të reja trajnuese.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2013		
RREZIQET		
Mungesa e mjeteve buxhetore.		
Pengesat e ndryshme administrative.		
KOMUNIKIMI		
OBJEKTIVI 1. Ngritja, avancimi dhe strukturimi i komunikimit brenda DK-së.		
TREGUESIT: Komunikimi efektiv dhe i strukturuar.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
SITUATA AKTUALE DK, për momentin shfrytëzon formën shkresore, verbale dhe elektronike të komunikimit që është e rregulluar me udhëzim administrativ. Menaxhmenti është në mënyrë aktive i përfshirë në zhvillimin efektiv të komunikimit të brendshëm. Sistemi i komunikimit të brendshëm ka lehtësuar në masë të madhe ofrimin dhe shkëmbimin e informacionit. Të gjitha format e komunikimit zyrtar janë krijuar në mënyrë që të sigurojnë së menaxherët dhe stafi të kenë marrë informacionin adekuat me kohë në lidhje me legjislacionin ekzistues si dhe procedurat dhe me ndryshimet që ndodhin. Sistemi i brendshëm i komunikimit mundëson dhe inkurajon komunikimin nga lartë poshtë dhe nga poshtë lartë, si dhe atë ndër sektorial funksional. Ekziston dhe është funksional Informatori Doganor- buletini, dhe folderi publik të cilat ofrojnë informacion për të gjithë punonjësit në lidhje me ngjarjet e tanishme në kuadër të DK-së	1. Të identifikohen problemet dhe ngeçjet në komunikim brenda agjencisë dhe të përpilohen instruksione të qarta për një komunikim më të avancuar dhe strukturuar.	MF DK Projektet e Binjakëzimit dhe Partnerët ndërkombëtar.

<p>dhe me ndikim për institucionin.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA</p> <p>Të zhvillohen, avancohen dhe strukturohen kapacitete të reja komunikimi brenda agjencisë edhe me forma dhe praktika tjera të cilat janë në harmoni edhe me EU Blueprint dhe praktikat tjera të mira, të cilat sigurojnë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - legjislacioni doganor dhe rregullat e brendshme janë aplikuar si duhet dhe njëtrajtësisht në tërë agjencinë dhe - strategjia e biznesit, politikat, sistemet dhe procedurat dhe ndryshimet në to të jenë komunikuar me kohë në tërë shërbimin. <p>Hap i rëndësishëm i cili duhet të merret në konsideratë është edhe zhvillimi dhe implementimi i sistemit të komunikimit të jashtëm i cili kërkon ta sjell mbështetjen publike dhe politike për Doganën e Kosovës.</p>		
<p>VEPRIM 1 Të identifikohen problemet dhe ngeçjet në komunikim brenda agjencisë dhe të përpilohen instruksione të qarta për një komunikim më të avancuar dhe strukturuar.</p>		
<p>AKTIVITETET</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësohet situatë aktuale. • Të evidentohen problemet dhe ngeçjet. • Të rishikohet UA për komunikim. • Të përgatitet projekti për ndryshimet e mundshme dhe të paraqitet për aprovim. • Të filloj zbatimi praktik. 		
<p>PËRPARËSIA: E lartë.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komunikim më i strukturuar. • Sistemi i komunikimit të brendshëm që lehtëson dhe promovon ofrimin e informacionit. 		
<p>TREGUESIT UA i rishikuar, instruksionet e qarta.</p>		
<p>AGJENCIA PËRGJEGJËSE: DK.</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: MF, DK, Projektet e Binjakëzimit, Partnerët ndërkombëtar dhe Grupi punues.</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT</p> <p>Agjencia DK.</p> <p>Kostot: Të parapara në buxhetin e agjencisë dhe donatorët e mundshëm.</p> <p>Përfitimet: Agjencion që ka komunikim të strukturuar dhe të avancuar.</p>		
<p>KOHËZGJATJA: 1 vit prej aprovimit të PV.</p>		
<p>KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2013.</p>		
<p>RREZIQET: Mos normimi i procedurave standarde të miratuara.</p>		

TEKNOLOGJIA INFORMATIVE		
OBJEKTIVI 1: Integrimi i Portalit të Tregtarëve dhe platformës për inteligjence biznesi Cognos me sistemin ASYCUDA.		
TREGUESIT: Sistem i integruar doganor me mundësi të ndërlidhjes.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
<p>SITUATA AKTUALE Gjendja aktuale në DK sa i përket automatizimit të procedurave doganore është e mirë, mirëpo mund të konsiderohet se ka hapësirë për përmirësim të mëtutjeshëm.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Të bëhet avancimi i sistemit edhe me forma tjera aplikative duke u bazuar edhe në objektivat strategjike të dala nga dokumenti EU Blueprint.</p>	<p>1. Implementimi i sistemit dhe integrimi i plotë me modulet të cilat mundësojnë bashkëpunimi efikas me agjencitë dhe palët tjera.</p>	<p>MF</p> <p>DK</p> <p>DAPD</p> <p>Organizatrat Ndërkombëtare</p> <p>dhe Projekti i Binjakëzimit (MIK).</p>
VEPRIM 1 Avancimi i sistemit edhe me forma tjera aplikative me qëllim që të përmbushen standardet në bazë të dokumentit më objektiva strategjike EU Blueprint.		
AKTIVITETET		
<ul style="list-style-type: none"> • Të koordinohet aktivitetet me agjencitë tjera. • Të përshkruhen kërkesat funksionale për të gjithë palët e involvuara. • Të krijohet një grup punues që të jep propozim për zgjidhje të mundshme. • Të filloj zbatimi praktik. 		
PËRPARËSIA: E mesme.		
REZULTATI I PRITUR: Përmbushja e standardeve të dala nga dokumenti EU Blueprint.		
TREGUESIT		
<ul style="list-style-type: none"> • Nevojat e identifikuar. • Sistem unik për informimin e tregtarëve. • Plani i hartuar dhe miratuar. 		
AGJENCIA PËRGJEGJËSE: DK.		
AKTORËT E PËRFSHIRË: MF/Dogana, DAPD, Organizatat ndërkombëtare.		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
<p>Agjencia Dogana.</p> <p>Kostot: Kosto të parapara për shpenzime në kuadër të buxhetit për vitin 2012 dhe në vazhdimësi.</p> <p>Përfitimet: Modernizimi i pajisjeve dhe profesionalizimi i stafit.</p>		
KOHËZGJATJA Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2014		
RREZIQET		
<p>Mos aprovimi i projektit.</p> <p>Mungesa e mjeteve buxhetore.</p>		

Pengesat e ndryshme administrative/ligjore.		
INFRASTRUKTURA DHE PAJISJET		
OBJEKTIVI 1. Zhvillimi i politikave për investime dhe sistemeve mbështetëse për të përcaktuar nevojat afatshkurtra , afatmesme dhe afatgjata të DK-së, në sferën e infrastrukturës dhe pajisjeve.		
TREGUESIT Planet investuese të përgatitura dhe miratuara.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
<p>SITUATA AKTUALE</p> <p>Dogana e Kosovës, për çdo vit i përcakton prioritetet në investim në infrastrukturë dhe pajisje. Të gjitha projektet dhe planet për investime analizohen, shqyrtohen me kujdes dhe miratohen rregullisht nga të gjitha nivelet e menaxhimit të organizatës në bashkërendim me MF. Shfrytëzohet një metodologji formale për të vlerësuar nevojat e prokurimit. (p.sh analiza e kost benefitit) me të vetmin qëllim që sistemi të jetë në funksion për të shqyrtuar dhe vlerësuar rregullisht nevojat për infrastrukturë më moderne dhe kosto efektive si dhe pajisje teknologjike.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA</p> <p>Të hartohen dhe publikohen politika investuese dhe financiare afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të cilat përcaktojnë qartë qëllimet dhe standardet për infrastrukturën dhe pajisjet në përputhje me strategjinë e punës së Doganës së Kosovës dhe njëkohësisht, të jenë të arsyeshme dhe gjithëpërfshirëse. Infrastruktura përcjellëse për ushtrimin e kontroleve duhet përshtatur specifikave të punës në varësi të PKK/ZD-ve. Është i nevojshëm shtimi i pajisjeve për kontroll në fusha të caktuara si me : X-Ray , aparate për detektim të drogave, si dhe të bëhet mirëmbajtja e pajisjeve aktuale.</p>	<p>1. Përgatitja e planeve për investime në infrastrukturë dhe pajisje bazuar në nevojat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate.</p>	<p>MF,</p> <p>DK</p> <p>DF&S Sektorët relevant</p> <p>Partnerët ndërkombëtar dhe donatorët .</p>
VEPRIM 1. Përgatitja e planeve për investime në infrastrukturë dhe pajisje bazuar në nevojat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate.		
AKTIVITETET		
<ul style="list-style-type: none"> • Të analizohet situata aktuale. • Të analizohen përparësitë dhe mangësitë. 		

- Të përgatitet projekti në tri faza lidhur me objektivin e paraparë.
- Të prezantohet para donatorëve të mundshëm.
- Të dërgohet për shqyrtim dhe aprovim në MF.
- Të filloj zbatimi praktik (në vazhdimësi).

PËRPARËSIA: E lartë.

REZULTATI I PRITUR: Planet dhe projektet e hartuara dhe miratuara.

TREGUESIT

- Zhvillimi i mekanizmave të brendshëm për të shqyrtuar dhe përshtatur politiken e investimeve të DK-së në përputhje me zhvillimet.
- Vendosja e programeve financiare për të mbështetur planet strategjike dhe investuese.
- Pajisjet moderne për kontroll të mallrave, identifikim të mallrave të ndaluara dhe kufizuara, zbulimit të narkotikëve si dhe mallrave kontrabandë.
- Infrastruktura adekuate për kontroll të njerëzve, mallrave si dhe automjeteve të transportit.

AGJENCIA PËRGJEGJËSE: DK.

AKTORËT E PËRFSHIRË: MF, DK, DF&S Partneret ndërkombëtar dhe donatorët.

KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT

Agjencia DK

Kostot: Të parapara në buxhetin e agjencisë dhe donatorët e mundshëm.

Përfitimet: Vendosja e sistemit menaxhues për të mbuluar qëllimet e veçanta, prioritetet dhe planet zhvillimore e financiare dhe për të siguruar ekuilibër ndërmjet investimit dhe burimeve.

KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.

KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2013

RREZIQET

Mos aprovimi i projekteve.

Mungesa e mjeteve buxhetore.

Pengesat e ndryshme administrative/ligjore.

AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË

KORNIZA LIGJORE

OBJEKTIVI 1: Harmonizimi i infrastrukturës ligjore konform kërkesave dhe praktikave të mira të BE-së.

TREGUESIT : Aktet nënligjore të miratuara.

KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
<p>SITUATA AKTUALE Aktualisht AUV funksionon në bazë të Ligjit të Ushqimit dhe ligjeve tjera me fushëveprim në sigurinë e ushqimit, shëndetit të kafshëve dhe bimëve. Për zbatimin e ligjeve ekzistuese gjatë periudhës së kaluar janë adaptuar një seri e akteve nënligjore.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Me qëllim të funksionalizimit sa më të mirë të ligjeve nevojitet të nxirren akte të reja nënligjore, bazuar në standardet evropiane dhe praktikatat e mira (EU Acquis).</p>	<p>1. Nxjerrja e akteve nënligjore në harmoni me Acquis Comunitaire të BE-së.</p>	<p>ZKM, MPBZHR, MSH, AUV IPA,TAIEX partnerët tjerë ndërkombëtar dhe Projekti i Binjakëzimit (MIK).</p>

VEPRIM 1: Nxjerrja e akteve nënligjore në harmoni me Acquis Comunitaire të BE-së.

AKTIVITETET

- Formimi i grupit punues ndër-sektorial.
- Analizimi dhe identifikimi i problemeve aktuale nga praktika.
- Fuqizimi i projektligjit të ri të Ligjit të Ushqimit dhe ligjeve tjera nga fusheveprimi i AUV-së sipas standardeve evropiane.
- Plotësim dhe ndryshimi i Udhëzimit Administrativ për Zbatimin e Legjislacionit në Fuqi.
- Zbatimi praktik.

PËRPARËSIA: E lartë.

REZULTATI I PRITUR

Hartimi dhe fuqizimi i akteve nënligjore të projektuara të cilat do të ndihmojnë në zbatimin e legjislacionit në fuqi e cila do të ndikojë në kontrolla më të mira kufitare dhe në brendësi bazuar në standardet evropiane dhe praktikatat e mira.

TREGUESIT

Aktet nënligjore të miratuara.
Legjislacioni i ri si dhe praktikatat e mira të BE-së.

AGJENCIA PËRGJEGJËSE: AUV

AKTORËT E PËRFSHIRË: ZKM, MPBZHR, AUV, IPA, TAIEX dhe partnerët tjerë ndërkombëtar dhe Projekti i Binjakëzimit (MIK).

KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT

Agjencia AUV

Kostot Të parapara në buxhetin e agjencisë dhe donatorët e mundshëm.

Përfitimet: Plotësimi i kornizës legislative në fushën e sigurisë së ushqimit, kafshëve dhe bimëve. Legjislacioni i harmonizuar, funksional dhe në harmoni me praktikatat e BE-së.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2013 (faza e parë)		
RREZIQET Mungesat e mjeteve buxhetore. Pengesat administrative dhe ligjore.		
ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI		
OBJEKTIVI 1: Hartimi i Planit Kombëtar të Kontrollave, monitorim i mbetjeve dhe ngritja profesionale e stafit sipas standardeve evropiane.		
TREGUESIT: Plani Kombëtar i Kontrollave dhe monitorimi i mbetjeve i miratuar dhe vënë në zbatim. Stafi i trajnuar sipas standardeve evropiane.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
SITUATA AKTUALE Aktualisht secili sektor brenda AUV-së ka të hartuar planin e kontrolleve. KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Bazuar në standardet dhe praktikatat e mira të BE-së, duhet të hartohet Plani Kombëtar për Kontroll, i cili në vete duhet të ngërthej të gjitha planet aktuale në një plan të vetëm.	1. Hartimi i planit kombëtar për kontroll dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit sipas standardeve evropiane dhe praktikave të mira.	ZKM, MBPZHR, MSH AUV TAIEX, IPA partnerët tjerë ndërkombëtar dhe Projekti i Binjakëzimit MIK.
VEPRIM 1 Hartimi i planit kombëtar për kontroll dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit sipas standardeve evropiane dhe praktikave të mira.		
AKTIVITETET 1. Formimi i grupit punues ndër-sektorial. 2. Analizimi dhe identifikimi i problemeve aktuale nga praktika. 3. Hartimi i draft planit për kontroll dhe hartimi i planit dhe programit për trajnime. 4. Dërgimi i planit për shqyrtim dhe miratim te organi përgjegjës. 5. Organizimi i trajnimeve në vazhdimësi. 5. Monitorimi i zbatimit praktik të planit të miratuar.		
PËRPARËSIA: E lartë.		
REZULTATI I PRITUR: Kontrolli kufitar bazuar në planin kombëtar.		
TREGUESIT: Plani Kombëtar i Kontrollit i miratuar dhe vënë në zbatim.		
AGJENCIA PËRGJEGJËSE: AUV,		
AKTORËT E PËRFSHIRË: ZKM, MPBZHR, MSH, AUV TAIEX, IPA dhe partneret tjere nderkombetar dhe Projekti i Binjakëzimit (MIK).		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT: Agjencia AUV		

Kostot: Të parapara në buxhetin e agjencisë dhe donatorët e mundshëm.		
Përfitimet: Siguri më e madhe në sferën e shëndetit publik. Staf profesional dhe i trajnuar në bazë të standardeve evropiane.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR: Qeshor 2013		
RREZIQET Mungesat e mjeteve buxhetore. Pengesat administrative dhe ligjore.		
PROCEDURAT		
OBJEKTIVI Harmonizimi i procedurave të kontrolleve kufitare dhe hartimi i manualit për inspektim kufitar sipas standardeve dhe praktikave të mira të BE-së.		
TREGUESIT: PSO -të dhe manuali i përpiluar dhe hamonizuara. Eliminimi i barrierave jotarifore.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
<p>SITUATA AKTUALE Aktualisht procedurat operative janë gati në tërësi të harmonizuara me praktikave të mira të BE. Grupet Punuese të AUV-së, kanë përgatitur PSO dhe kanë dhënë rekomandime të kohëpaskohshme për kontrollet kufitare. Këto dokumente janë përgatitur në bazë të legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtar, duke përfshirë praktikave të mira të BE-së.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Është e nevojshme që të zhvillohen dhe harmonizohen procedurat dhe praktikave të mira dhe standardet e BE-së.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të hartohen PSO të reja që përcaktojnë se si duhet të kryhen kontrollet e kufirit sipas standardeve dhe praktikave të mira të BE-së. 2. Të përgatiten manuali për inspektim kufitar. 	<p>ZKM, MPBZHR, AUV TAIEX, IPA, Partnerët tjerë ndërkombëtar dhe Projekti i Binjakëzimit (MIK).</p>
VEPRIM 1 Të hartohen PSO të reja që përcaktojnë se si duhet të kryhen kontrollet e kufirit sipas standardeve dhe praktikave të mira të BE-së.		
AKTIVITETET		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të formohet grupi punues ndërsektorial. 2. Të përcaktohen procedurat e kontrollit kufitar. 3. Të hartohen PSO të reja. 4. Të dërgohen për shqyrtim dhe miratim. 5. Të filloj zbatimi praktik. 		
PËRPARËSIA: E lartë.		
REZULTATI I PRITUR: PSO e miratuara.		
TREGUESIT: Procedurat e përpiluara dhe të vëna në zbatim.		
AGJENCIA PËRGJEGJËSE: AUV.		

AKTERËT E PËRFSHIRË: ZKM, MPBZHR AUV, TAIEX, IPA, partnerët tjerë ndërkombëtar dhe Projekti i Binjakëzimit MIK.		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Agjencia: AUV		
Kostot: Të parapara në buxhetin e agjencisë dhe donatorët e mundshëm.		
Përfitimet: Ngritja profesionale e stafit dhe zbatimi më i mirë i procedurave të kontrollit. Harmonizimi i procedurave dhe eliminimi i barrierave jotarifore.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2014		
VEPRIM 2 : Të hartohet Manuali i inspektimit kufitar.		
AKTIVITETET		
1.Të formohet grupi punues ndërsektorial.		
2.Hartimi i Manualit për inspektim kufitar.		
3.Draft i manualit të dërgohet për shqyrtim dhe miratim.		
4. Zbatimi praktik.		
PËRPARËSIA: E lartë.		
REZULTATI I PRITUR: Manuali i miratuar.		
TREGUESIT: Manuali i miratuar dhe vënë në zbatim.		
AGJENCIA PËRGJEGJËSE: AUV.		
AKTERËT E PËRFSHIRË: ZKM, MPBZHR AUV, TAIEX, IPA, partnerët tjerë ndërkombëtar dhe Projekti i Binjakëzimit (MIK).		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Agjencia: AUV		
Kostot: Të parapara në buxhetin e agjencisë dhe donatorët e mundshëm.		
Përfitimet: Ngritja profesionale e stafit dhe zbatimi më i mirë i procedurave të kontrollit. Harmonizimi i procedurave dhe eliminimi i barrierave jotarifore.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2015		
RREZIQET		
Mungesat e mjeteve buxhetore.		
Pengesat administrative dhe ligjore.		
BURIMET NJERËZORE DHE TRAJNIMI		
OBJEKTIVI 1. Trajnimi në vazhdimësi për sistemin e ri elektronik.		
TREGUESIT: Analiza e nevojave për trajnim. Kryerja e trajnimeve për sistemin e ri.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERET
SITUATA AKTUALE Trajnimet që zhvillohen janë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e drejtorive përkatëse, për zhvillim të mëtutjeshme të stafit.	1.Të përgatitet Plani dhe programi i trajnimeve për AUV.	ZKM, MPBZHR, AUV

<p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Duhet planifikuar trajnime për procedurat sistemin e ri elektronik si dhe integrimi në Assycuda World.</p>	<p>2. Zhvillimi i programeve të trajnimit bazuar në integrimin e sistemeve të reja të TI-së.</p>	<p>TAIEX, IPA, partneret tjerë ndërkombëtar dhe Projekti i Binjakëzimit (MIK).</p>
<p>VEPRIM 1. Të përgatitet plani dhe programi i trajnimeve për AUV.</p>		
<p>AKTIVITETET</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formohet grupi punues. • Analizimi i nevojave të trajnimit. • Përgatitja e programit trajnues. • Miratimi i programit. • Organizimi i trajnimeve. 		
<p>PËRPARËSIA: E lartë.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR: Analiza e nevojave dhe përgatitja e programit për trajnime të AUV-së.</p>		
<p>TREGUESIT : Programi i miratuar.</p>		
<p>AGJENCIA PËRGJEGJËSE AUV</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: ZKM, MPBZHR AUV, TAIEX, IPA, partneret tjerë ndërkombëtar dhe Projekti I Binjakëzimit (MIK).</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT Agjencia: AUV Kostot: Të parapara në buxhetin e agjencisë dhe donatorët e mundshëm. Përfitimet: Trajnimet profesionale për stafin, ngritja profesionale.</p>		
<p>KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.</p>		
<p>KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2013</p>		
<p>RREZIQET Mungesat e mjeteve buxhetore. Pengesat administrative dhe ligjore.</p>		
<p>Veprimi 2: Zhvillimi i programeve të trajnimit bazuar në integrimin e sistemeve të reja të TI-së.</p>		
<p>AKTIVITETET</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formohet grupi punues. • Sektori i Trajnimeve DK-së dhe AUV-së të përgatisin kalendarin e trajnimeve për sistemin e ri ASSYCUDA World* plani përbashkët për ASSYCUDA World. • Miratimi i kalendarit trajnues. • Zbatimi i programeve. 		
<p>PËRPARËSIA : E mesme.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR: Personeli i AUV-së merr trajnim të standardizuar bazuar në nevojat e trajnimeve.</p>		
<p>TREGUESIT: Programet e trajnimit të AUV-së janë përgatitur dhe vënë në zbatim.</p>		
<p>AGJENCIA PËRGJEGJËSE: DK,AUV</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: ZKM, MPBZHR,AUV, TAIEX, IPA, partnerët tjerë ndërkombëtar dhe Projekti i Binjakëzimit (MIK).</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT</p>		

<p>Agjencia: AUV</p> <p>Kostot: Të parapara në buxhetin e agjencisë dhe donatorët e mundshëm.</p> <p>Përfitimet: Trajnimi dhe specializimi i personelit i bazuar në programe të reja trajnuese.</p>		
<p>KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.</p>		
<p>KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2013</p>		
<p>RREZIQET</p> <p>Mungesat e mjeteve buxhetore.</p> <p>Pengesat administrative dhe ligjore.</p>		
<p>KOMUNIKIMI</p>		
<p>OBJEKTIVI: Avancimi dhe strukturimi i komunikimit brenda agjencisë.</p>		
<p>TREGUESIT: Komunikimi efektiv dhe i strukturuar.</p>		
<p>KONTEKSTI</p>	<p>VEPRIMET E PROPOZUARA</p>	<p>AKTERET</p>
<p>SITUATA AKTUALE</p> <p>Aktualisht AUV shfrytëzon formën shkresore, verbale dhe elektronike dhe është i rregulluar me akte ligjore dhe manual komunikimi të cilat shfrytëzohen edhe nga qeveria. Sistemi i komunikimit të brendshëm ka lehtësuar në masë të madhe ofrimin dhe shkëmbimin e informacionit. Sistemi i brendshëm i komunikimit mundëson dhe inkurajon komunikimin nga lartë poshtë dhe nga poshtë lartë si dhe atë ndër sektorial funksional.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA</p> <p>Zhvillimi, avancimi dhe strukturimi i kapaciteteve të komunikimi brenda agjencisë bazuar në forma dhe praktika të mira, të cilat janë në harmoni me standardet e BE-së. Hap i rëndësishëm i cili duhet të merret në konsideratë është edhe informimi publik dhe komunikimi i jashtëm. Praktika e komunikimit ndërmjet agjencisë në MIK është një praktikë e mirë.</p>	<p>1. Të identifikohen problemet dhe ngecjet në komunikim brenda agjencisë dhe të përpilohen instruksione të qarta për një komunikim më të avancuar dhe strukturuar.</p>	<p>ZKM, MPBZHR,</p> <p>AUV</p> <p>TAIEX, IPA,</p> <p>partneret tjere nderkombetar dhe</p> <p>Projekti i Binjakëzimit (MIK).</p>
<p>VEPRIM 1 Identifikimi i problemeve dhe ngecjeve në komunikim brenda agjencisë dhe të përpilohen instruksione të qarta për një komunikim më të avancuar dhe strukturuar.</p>		
<p>AKTIVITETET</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësohet situatë aktuale. • Të evidentohen problemet dhe ngecjet. 		

<ul style="list-style-type: none"> • Të krijohet një grup punes që të propozoj zgjidhje të mundshme. 		
PËRPARËSIA		
E lartë.		
REZULTATI I PRITUR		
Komunikimi më i avancuar dhe i strukturuar.		
TREGUESIT		
Situata e vlerësuar, instruksionet e qarta, komunikimi i avancuar.		
AGJENCIA PËRGJEGJËSE		
AUV		
AKTERËT E PËRFSHIRË		
ZKM, MPBZHR, AUV, TAIEX, IPA, partnerët tjerë ndërkombëtar dhe Projekti i Binjakëzimit (MIK).		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Agjencia AUV		
Kostot: Të parapara në buxhetin e agjencisë dhe donatorët e mundshëm.		
Përfitimet: Komunikimi më i avancuar.		
KOHËZGJATJA		
Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR		
Qershor 2013		
RREZIQET		
Mungesat e mjeteve buxhetore.		
Pengesat administrative dhe ligjore.		
TEKNOLOGJIA INFORMATIVE		
OBJEKTIVI Avancimi i sistemit aktual të TI në PIK.		
TREGUESIT: Mundësia e Informimit direkt(online) të operatorve të biznesit.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERET
SITUATA AKTUALE TI në PIK bazohet në telefon mobil, fix, internet, qasja në bazën e të dhënave sofwerike i instaluar në PIK.TI AVUK është e mbyllur vetëm për nevoja të AUV-së.	1. Aplikimi i TI i cili mundëson lidhje të plotë me modulet të cilat mundësojnë bashkëpunimi efikas me agjencitë dhe palët tjera të interesit.	ZKM, MPBZHR, AUV TAIEX, IPA, partnerët tjere ndërkombëtar dhe Projekti i Binjakëzimit (MIK).
KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Avancimi i sistemit edhe me forma tjera aplikative duke u bazuar në “Praktikat e Mira”.		
VEPRIM 1 Avancimi i sistemit aktual të TI-së.		
AKTIVITETET		
1. Të koordinohet aktivitetet me agjencionet tjera.		

<p>2. Të përshkruhen kërkesat funksionale për të gjithë palët e involvuara.</p> <p>3. Të krijohet një grup punues që të jep propozim për zgjidhje të mundshme.</p>		
PËRPARËSIA: E lartë.		
REZULTATI I PRITUR		
Avancimi i sistemit aktual të TI-së.		
TREGUESIT		
Nevojat e identifikuar.		
Sistem unik për informimin e aritjës së ngarkesës.		
Plani i hartuar dhe miratuar.		
AGJENCIA PËRGJEGJËSE: AUV		
AKTERËT E PËRFSHIRË: AUV,MPBZHR.		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Agjencia: AUV		
Kostot: Të parapara në buxhetin e agjencisë dhe donatorët e mundshëm.		
Përfitimet: Avancimi i TI-së.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2016		
RREZIQET: Mungesat e mjeteve buxhetore.		
INFRASTRUKTURA DHE PAJISJET		
OBJEKTIVI Zhvillimi i politikës për investime të përcaktuar nevojat afatshkurtra , afatmesme dhe afatgjata të PIK-vë, në sferën e infrastrukturës dhe pajisjeve.		
TREGUESIT Planet investive të përgatitura dhe të miratuara.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERET
<p>SITUATA AKTUALE</p> <p>Infrastruktura aktuale nuk i plotëson kriteret për kontroll kufitar (veterinar dhe fitosanitar) nuk ka hapësira të mjaftueshme për kontroll zyrtar dhe përgatitje të mostrës.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA</p> <p>Duhet të sigurohet infrastruktura e nevojshme për inspektimin veterinar kufitar bazuar në standardet e BE-së dhe praktikat e mira.</p>	<p>1. Përgatitja e planeve për investime bazuar në nevojat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate.</p>	<p>ZKM, MPBZHR,</p> <p>AUV</p> <p>TAIEX, IPA</p> <p>partnerët tjerë ndërkombëtar dhe Projekti i Binjakëzimit (MIK).</p>
VEPRIM 1. Përgatitja e planeve për investime bazuar ne nevojat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate, duke pasë në konsideratë edhe çështjen e mirëmbajtjes.		
AKTIVITETET		
<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i nevojave dhe përgatitja e projekteve. • Të sigurohet infrastruktura dhe pajisjet në përputhje me standartet e BE-së. • Të analizohen përparësitë dhe mangësitë. 		

- Të përgatitet projekti në tri faza lidhur me objektivin e paraparë.
- Të dërgohet për shqyrtim dhe aprovim në MF.
- Të filloj zbatimi praktikë- (në vazhdimësi), duke patur në konsideratë edhe çështjen e mirëmbajtjes.

PËRPARËSIA

E lartë.

REZULTATI I PRITUR

Planet dhe projektet e hartuara për PIK.

TREGUESIT

Zhvillimi i mekanizmave të brendshëm për të shqyrtuar dhe përshtatur politiken investimeve të AUV-se në përputhje me vendimet e qeverisë për PIK. Vendosja e programeve financiare për të mbështetur planet strategjike dhe investuese.

AGJENCIA PËRGJEGJËSE

AUV

AKTERËT E PËRFSHIRË

MAP, AUV, MBPZHR, IPA etj.

KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT

Agjencia AUV

Kostot: Të parapara në buxhetin e agjencise dhe donatoret e mundshëm

Përfitimet: Infrastruktura dhe pajisjet sipas standardeve të BE-së.

KOHËZGJATJA

Në vazhdimësi

KALENDARI I PROPOZUAR

Qershor 2017

RREZIQET

Mungesat e mjeteve buxhetore.

Pengesat e ndryshme administrative dhe ligjore.

BASHKËPUNIMI NDËRMJET AGJENCIVE

(PK-DK-AUV)

KORNIZA LIGJORE

OBJEKTIVI 1: Arritja e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit mes agjencive dhe institucioneve tjera relevante që nuk janë të përfshira në MIK.

TREGUESIT: Marrëveshjet e nënshkuara dhe të vëna në zbatim.

KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
<p>SITUATA AKTUALE Bashkëpunimi ndërmjet agjencive është rregulluar përmes ligjeve përkatëse dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Rishikimi i marrëveshjeve dhe plotësimi i atyre ekzistuese dhe zbatimi i tyre do të përmirësoj gjithë spektrin dhe bashkërendimin e aktiviteteve në zbatim të ligjit, me qëllim të përmirësimit dhe bashkërendimit ndërinstytucionale. Kjo është edhe kërkesë sipas standardeve dhe praktikave të mira të BE-së.</p>	<p>1. Rishikimi, plotësimi dhe nxjerrja e marrëveshjeve sipas nevojës.</p>	<p>ZKM, MPB, MF, MD, MBPZHR, MI, MTI, MSH, MAP, MPJ, dhe partnerët ndërkombëtar.</p> <p>PK, DK, AUV</p> <p>Projekti i Binjakëzimit (MIK).</p>

VEPRIM 1. Rishikimi, plotësimi dhe nxjerrja e marrëveshjeve sipas nevojës.

AKTIVITETET

1. Formimi i grupeve punuese ndërmjet agjencive.
2. Inicimi i vlerësimit të marrëveshjeve në fuqi ndërmjet agjencive kufitare.
3. Përgatitja e udhërrëfyesit për hartimin e MM në përputhje me Aquis Communitare dhe udhërrëfyesin e KE për MIK në bazë të prioritetëve, interesit dhe afateve të përcaktuara.
4. Hartimi i marrëveshjeve reja.
5. Miratimi dhe vënia në zbatim.
6. Monitorimi i zbatimit praktik.

PËRPARËSIA: E lartë.

REZULTATI I PRITUR: Bashkërendimi i veprimeve ndërmjet agjencive dhe institucioneve.

TREGUESIT: Marrëveshjet e nënshkuara dhe zbatimi i tyre.

AGJENCITË PËRGJEGJËSE: ZKM, MPB, MF, MBPZHR, MI, MTI, MSH, MAP, MPJ, dhe partnerët ndërkombëtarë, PK, DK, AUV, Projekti i Binjakëzimit (MIK) dhe palët nënshkruese.

AKTERËT E PËRFSHIRË: PK, DK, AUV dhe institucionet tjera relevante.

KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT

Agjencia: PK, DK, AUV.

Kostot: Të parapara në buxhetin e agjencive.

Përfitimet: Ngritja e bashkëpunimit, bashkërendimi i aktiviteteve, mos dyfishimi i aktiviteteve, rritja e efikasitetit dhe efektivitetit.

KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.

KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.		
RREZIQET Pengesat e ndryshme administrative/ligjore.		
ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI		
OBJEKTIVI 1. Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të agjencive kufitare në përgjigje ndaj kërcënimeve, rreziqeve dhe ndryshimeve në sigurinë e kufirit.		
TREGUESIT: Kapacitetet e ngritura dhe funksionale.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
<p>SITUATA AKTUALE</p> <p>Agjencitë shtetërore të Republikës së Kosovës kanë ngritur disa kapacitete, mirëpo ende nuk janë zhvilluar kapacitetet maksimale dhe të duhura që të kemi një pamje të qartë të situatës së sigurisë në kufi, duke marrë në konsideratë të gjitha njohuritë në dispozicion lidhur me trafikun kufitar, situatën në emigrimin e paligjshëm, trafiqet e paligjshme në nivelin ndërkuftar dhe atë transnacional. Mungesa e dyanshme e rrjedhës së informacionit, mungesa e informacionit analitik të përpunuar dhe analiza e rrezikut e pazhvilluar në nivel optimal kanë rezultuar në pamundësinë e vazhdueshme për të marrë vendime në kohën e duhur dhe të saktë për një trajtim të përbashkët në kufi. Agjencitë në kuadër të MIK –ut, kanë krijuar një mekanizëm të përbashkët të profilimit dhe analizës së rrezikut dhe kërcënimeve për PKK-të dhe vijën e gjelbër dhe kaltër dhe në baza tremujore përpilojnë raporte analitike. Ngecje në këtë aspekt ka në nivelin rajonal dhe lokal të cilat nuk janë plotësisht në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të BE-së.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA</p> <p>Menaxhimi i operacioneve në kufi dhe në brendi të Republikës së Kosovës, duhet të bazohet në vlerësimin dhe analizën e vazhdueshme të situatës në kufi, në brendësi të territorit, rreth kufijve shtetëror dhe në rajon. Është e nevojshme që të krijohet një</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Krijimi i mekanizmave funksional dhe sistemit të përshtatshëm që ndërlidhet me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave dhe aktiviteteve të kundërligjshme. 2. Krijimi i mekanizmave rajonal dhe lokal për analizë të rrezikut dhe shkëmbim të informatave. 3. Zhvillimi i sistemit për paralajmërimin të hershëm. 	<p>ZKM, MPB, MF,</p> <p>PK, DK, AUV dhe agjencionet tjera me fushëveprim në kufi EULEX Partnerët ndërkombëtar dhe Projektet e Binjakëzimit.</p>

<p>mekanizëm funksional dhe një sistem i përshtatshëm që ndërlidhet me parandalimin hetimin dhe zbulimin e veprave dhe aktiviteteve të kundërligjshme dhe për paralajmërim të hershëm, me qëllim të një kontrolli sa më efektiv dhe efikas të kufirit në të gjitha nivelet. Zyrtarët kufitar të cilët punojnë në kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, është e nevojshme që vazhdimisht të sigurojë informacion në lidhje me treguesit e rrezikut dhe kërcënimeve të mundshme për sigurinë kufirit dhe të vendit në përgjithësi. Edhe pse është krijuar mekanizmi qendror duhet të krijohen mekanizmat lokal dhe rajonal për analizë të rrezikut dhe të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet më ngushtë me mekanizmin qendror për Analizën e Riskut.</p>		
<p>VEPRIM 1 Krijimi i mekanizmave funksional dhe sistemit të përshtatshëm që ndërlidhet me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave dhe aktiviteteve të kundërligjshme.</p>		
<p>AKTIVITETET:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të formohet grupi punues ndërmjet agjencie. • Të analizohet situata aktuale dhe analizohen përparësitë dhe mangësitë e objektivit aktual. • Të përgatitet strategjia/plani dhe udhëzimet për veprim. • Të dërgohet për shqyrtim dhe miratim. • Të organizohet ndonjë vizitë studimore me qëllim të marrjes së përvojave. • Të përzgjidhet një rajon dhe PKK ku do të testohet funksionimi i mekanizmave dhe sistemit. • Të filloj zbatimi praktik. 		
<p>PËRPARËSIA: E lartë.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR: Kapacitetet e ngritura, plani i përgatitur, udhëzimet e përpiluara, mekanizmat funksional.</p>		
<p>TREGUESIT Krijimi i mekanizmave funksional dhe sistemit të përshtatshëm që ndërlidhet me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave dhe aktiviteteve të kundërligjshme. Kontrolli sa më efektiv dhe efikas i kufirit shtetëror bazuar në standardet evropiane dhe praktikatat e mira.</p>		
<p>AGJENCIA PËRGJEGJËSE PK, DK, AUV</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË ZKM , MPB, MF, PK, DK, AUV dhe ato më fushëveprim në kufi, EULEX, partnerët ndërkombëtar dhe projektet e binjakëzimit.</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT Agjencia: PK, DK, AUV. Kostot: Kërkon shpenzime shtesë në përputhje me projektet për kufirin e MPB-së dhe agjencie kufitare (kjo duhet të bashkërendohet mes MPB dhe MF).</p>		

Përfitimet: Rritja e sigurisë kufitare dhe sigurisë së vendit.
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi .
KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2014
RREZIQET Mos aprovimi i projektit. Mungesa e mjeteve buxhetore.
VEPRIM 2 Krijimi i mekanizmave rajonal dhe lokal për analizë të rrezikut dhe shkëmbim të informatave.
AKTIVITETET <ul style="list-style-type: none"> • Të formohet grupi punues ndërmjet agjencive. • Të analizohet situata aktuale dhe analizohen përparësitë dhe mangësitë e objektivit. • Të përgatitet plani dhe udhëzimet për veprim. • Të dërgohet për shqyrtim dhe miratim. • Të shihet mundësia e organizimit të ndonjë vizitë studimore me qëllim të marrjes së përvojave. • Të përzgjidhet një rajon dhe PKK ku do të testohet funksionimi. • Të filloj zbatimi praktik.
PËRPARËSIA: E lartë.
REZULTATI I PRITUR: Kapacitetet e ngritura, udhëzimet e përpiluara, mekanizmi funksional.
TREGUESIT Ngritja e mekanizmave rajonal dhe lokal për analizë të rrezikut. Krijimi i mekanizmave funksional dhe sistemit të përshtatshëm që ndërlidhet me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave dhe aktiviteteve të kundërligjshme. Kontrolli sa më efektiv dhe efikas i kufirit shtetëror bazuar në standardet evropiane dhe praktikatat e mira.
AGJENCIA PËR GJEGJËSË PK, DK, AUV.
AKTERËT E PËRFSHIRË ZKM , MPB, MF, PK, DK. AUV, partnerët ndërkombëtar dhe Projektet e Binjakëzimit.
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT Agjencia PK, DK, AUV Kostot: Kërkon shpenzime shtesë në përputhje me projektet për kufirin e MPB-së dhe agjencive kufitare (bashkërendim mes MPB dhe MF). Përfitimet: Rritja e sigurisë kufitare dhe sigurisë së vendit.
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.
KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2014
RREZIQET Mos aprovimi i projekteve. Mungesa e mjeteve buxhetore.
VEPRIM 3: Zhvillimi i sistemit për paralajmërimin të hershëm .
AKTIVITETET <ul style="list-style-type: none"> • Të formohet grupi punues ndërmjet agjencive. • Të analizohet gjendja aktuale e sistemeve ekzistuese dhe analizohen përparësitë dhe mangësitë. • Të shihet mundësia e organizimit të ndonjë vizitë studimore me qëllim të marrjes së përvojave. • Të përgatitet projekti strategjik.

<ul style="list-style-type: none"> • Të përgatitet plani i detajuar dhe udhëzimet për veprim. • Të dërgohet për shqyrtim në MPB dhe te agjencitë përgjegjëse. • Të përzgjidhet PKK si pilot projekt. • Të aprovohet projekti. • Të filloj zbatimi praktik. 		
PËRPARËSIA: E lartë.		
REZULTATI I PRITUR: Kapacitetet e ngritura. Sistemi i ngritur dhe testuar. Udhëzimet e përpiluara. Mekanizmat funksional. Shkëmbimi i informatave.		
TREGUESIT: Ngritja e sistemit për paralajmërim të hershëm. Krijimi i mekanizmave për paralajmërim të hershëm dhe sistemit të përshtatshëm që ndërlihet me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave dhe aktiviteteve të kundërligjshme. Kontrolli sa më efektiv dhe efikas i kufirit shtetëror bazuar në standardet evropiane.		
AGJENCIA PËRGJEGJËSE: PK, DK, AUV		
AKTERËT E PËRFSHIRË: MPB, MF, ZKM, Agjencitë e MIK-ut, agjencitë tjera me fushëveprim në kufi dhe partnerët ndërkombëtar.		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Agjencia PK, DK, AUV		
Kostot: Kërkon shpenzime shtesë në përputhje me projektet për kufirin të MPB-së dhe agjencive kufitare (bashkërendim i MPB-së dhe MF-së).		
Përfitimet: Rritja e sigurisë kufitare dhe sigurisë së vendit.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2015		
RREZIQET		
Mos aprovimi i projektit.		
Mungesa e mjeteve buxhetore.		
ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI		
OBJEKTIVI 2 Avancimi i kapaciteteve vepruese në luftimin e të gjitha formave të aktiviteteve të kundërligjshme ndërkufitare dhe transnacionale, me fokus të veçantë në parandalimin dhe zbulimin e drogave, kontrabandimit të armëve dhe municionit, armëve të shkatërrimit në masë, mjeteve radioaktive, trafikimit të qenieve njerëzore, migrimit ilegal, etj.		
TREGUESIT: Ekipet e suksesshme dhe efektive në parandalimin e të gjitha formave të aktiviteteve të kundërligjshme.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
SITUATA AKTUALE Janë krijuar dhe trajnuar ekipe për luftimin e aktiviteteve të kundërligjshme dhe trafikeve ilegale në kuadër të secilës agjenci të përfshirë në MIK dhe agjencive tjera me fushëveprim në kufi. Edhe përkundër rezultateve të përditshme ekziston nevoja që këto aktivitete të avancohen dhe të shtohen	1. Zhvillimi i objektivave, hartimi i planeve dhe udhëzimeve të qarta për të parandaluar dhe luftuar aktivitetet e kundërligjshme dhe trafikeve ilegale.	ZKM, MPB, MF, DK, PK, AUV AMRK

<p>kapacitete vepruese në parandalimin dhe luftimin e aktiviteteve të kundërligjshme ndërkufitare dhe brenda territorit.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Duhet të përcaktohen objektiva të qarta dhe detyra shtesë për luftimin e aktiviteteve të kundërligjshme dhe trafikeve ilegale duke u bazuar në Strategjitë kombëtare të RKS-së dhe në standardet evropiane dhe praktikat e mira, gjithmonë duke marrë në konsideratë sigurinë e shtetit. Duhet të sigurohen mjete buxhetore, numër i mjaftueshëm i personelit të kualifikuar dhe të trajnuar dhe pajisjeve adekuate.</p>	<p>2. Sigurimi i mjeteve buxhetore, numrit të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar dhe të trajnuar dhe pajisjeve adekuate.</p>	<p>EULEX Partnerët ndërkombëtar dhe donatorët e mundshëm.</p>
<p>VEPRIM 1 Zhvillimi i objektivave, hartimi i planeve dhe udhëzimeve të qarta për të luftuar aktivitetet e kundërligjshme dhe trafikeve ilegale.</p>		
<p>AKTIVITETET</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të formohet grupi punues ndërmjet agjencive. • Të analizohet situata aktuale dhe analizohen përparësitë dhe mangësitë. • Të përgatitet plani dhe udhëzimet për veprim. • Të dërgohet për shqyrtim dhe miratim te organi kompetent. • Të filloj zbatimi praktik. 		
<p>PËRPARËSIA: E lartë.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR: Ekipe të suksesshme dhe efektive për të luftuar aktivitete e kundërligjshme.</p>		
<p>TREGUESIT: Objektivat e vendosura, planet e gatshme, udhëzimet e qarta dhe struktura e trajnuar mirë.</p>		
<p>AGJENCIA PËRGJEGJËSE: DK, PK, AUV.</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: ZKM ,MPB, MF, PK, DK, AUV , AMRK , EULEX dhe partnerët ndërkombëtar.</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT Agjencia: DK, PK AUV dhe AMRK Kostot: Të parapara me buxhetin e agjencive. Përfitimet: Strukturë e profesionalizuar në fushën e zbatimit të ligjit dhe parandalimit të aktiviteteve të kundërligjshme.</p>		
<p>KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.</p>		
<p>KALENDARI I PROPOZUAR : Qershor 2013</p>		
<p>RREZIQET Mos aprovimi i planit dhe udhëzimeve për veprim. Mungesa e mjeteve buxhetore.</p>		
<p>VEPRIM 2. Sigurimi i mjeteve buxhetore, numrit të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar dhe të trajnuar dhe pajisjeve adekuate.</p>		
<p>AKTIVITETET</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të formohet grupi punues . • Të analizohet situata aktuale e fondeve, numrit të personelit dhe pajisjeve. 		

- Të analizohen nevojat për të ardhmen bazuar në planet afatmesme dhe afatgjata.
- Të përgatitet projekti i përgjithshëm dhe udhëzimet për veprim.
- Të dërgohet për shqyrtim te organi përgjegjës.
- Të filloj zbatimi praktik i projektit.

PËRPARËSIA: E mesme.

REZULTATI I PRITUR: Fondet e siguruar, numër i mjaftueshëm dhe personel i trajnuar.

TREGUESIT: Planet e gatshme, udhëzimet e qarta dhe struktura e trajnuar mirë.

AGJENCIA PËRGJEGJËSE: DK, PK, AUV dhe AMRK.

AKTERËT E PËRFSHIRË : MPB, MF, ZKM PK, DK, AUV, agjencite tjera me fushëveprim në kufi dhe partnerët ndërkombëtar dhe donatorët e mundshëm.

KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT

Agjencia: DK, PK AUV dhe AMRK

Kostot: Të parapara me buxhetin e agjencive dhe donatorët e mundshëm.

Përfitimet: Strukturë e profesionalizuar në fushën e zbatimit të ligjit dhe parandalimit të aktiviteteve të kundërligjshme.

KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.

KALENDARI I PROPOZUAR: Qershor 2014

RREZIQET

Mos aprovimi i projektit.

Mungesa e mjeteve buxhetore.

ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI

OBJEKTIVI 3: Zhvillimi dhe implementimi i sistemit menaxhues dhe organizativ i cili eliminon apo i minimizon mundësitë për sjellje të këqija dhe korrupsion.

TREGUESIT: Zbatimi praktik i Kodit Etik

KONTEKSTI

VEPRIMET E PROPOZUARA

AKTERËT

